



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 406/1 prot.

Tiranë më 19.3.2020

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 1596/2 Prot., datë 09.03.2020, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për garantimin e rregullit dhe sigurisë në gjykata dhe prokurori", Zyra e Komisionerit vlerëson përfshirjen e disa sugjerimeve konform legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në këtë kuadër, sugjerojmë që germa gj) e pikës 2, e ndarjes II, të riformulohet në:
"Vendosjen e rregullave dhe procedurave në lidhje me ruajtjen dhe instalimin e pajisjeve të sigurisë, si dhe ruajtjen dhe shkatërrimin e dokumentacionit, regjistrave fizikë ose elektronikë, sistemeve dhe çdo mjeti ose pajisjeje tjetër nëpërmjet të cilit administrohen dhe përpunohen të dhënat personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale".

Pas germës h) të pikës 2, të ndarjes II, të shtohet germa i) me përmbajtje si vijon: *"i) Përcaktimin e rregullave dhe masave në kuadër të garantimit të konfidencialitetit dhe sigurisë së të dhënave personale që do të përpunohen gjatë implementimit të masave të sigurisë fizike".*

Pas pikës 4 të kreut III, të shtohet një paragraf me përmbajtje si vijon: *“Prokuroritë dhe gjykatat kanë detyrimin të përcaktojnë personat përgjegjës që do të kenë akses në sistemet e kamerave dhe në të njëjtën kohë janë të detyruara të përcaktojnë rregulla specifike lidhur me përpunimin e të dhënave personale në përputhje me Udhëzimin Nr. 3, datë 05.03.2010 mbi “Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”.*

Me përfshirjen e parashikimeve të sugjeruara sa më sipër, projektvendimi vlerësohet i hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

